



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.1, datë 07.10.2020

PËR

**MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL
NË FUSHËN E TRANSPORTIT DETAR DHE INFRASTRUKTURËS PORTUALE**

Në mbështetje të neneve 7, 8, 9, 10, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 881, datë 14.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”, Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit:

VENDOSI:

1. Miratimin e Nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale.
2. Dokumenti i plotë i Nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale, përmban:
 - a) analizën, e cila përcakton qëllimin dhe nevojën për hartim ose rishqyrtim të dokumentit të planifikimit;
 - b) kufijtë e territorit që mbulon dokumenti i planifikimit;
 - c) listën e dokumenteve përbërëse të PKS-së;
 - d) ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës, hartues të PKS-së;
 - e) përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit e takimeve publike dhe afatet përkatëse;
 - f) planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të PKS-së;
 - g) buxhetin për hartimin e PKS-së.
3. Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale me ekspertë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucioneve të varësisë.

Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



ANILA DENAJ
ANËTAR I KKT



ETILDA GJONAJ
ANËTAR I KKT



ELVA MARGARITI
ANËTAR I KKT



BLEDI ÇUÇI
ANËTAR I KKT



BLENDI KLOSI
ANËTAR I KKT



EDUARD SHALSI
ANËTAR I KKT

